LIGJ
Nr. 20/2019

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 12/2018 "PËR VLERËSIMIN KALIMTAR DHE PERIODIK TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, GARDËS SË REPUBLIKËS DHE SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT NË MINISTRINË E BRENDSHME"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pikat 1 e 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 12/2018, "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme", bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. "Organet e vlerësimit kalimtar" janë Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.".

2. Pika 21, shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 5 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Organet e vlerësimit kalimtar janë Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.".

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit organizohet në trupa vlerësimi, të cilat veprojnë në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe janë përgjegjëse për verifikimin, vlerësimin, si dhe për marrjen e vendimeve ndaj punonjësve.".

3. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

"6. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit mbështetet gjatë veprimtarisë së tij nga një sekretariat teknik, sipas parashikimeve të këtij ligji.".

Neni 3

Në nenin 6 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, shkronja "b", ndryshohet si më poshtë:

"b) komandant, zëvendëskomandant dhe kolonel në Gardën e Republikës;".

2. Në pikën 1, shkronja "c", ndryshohet si më poshtë:

"c) punonjësit në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.".

3. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat vlerëson të gjithë punonjësit e tjerë të Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës.".

4. Pikat 3 dhe 4 shfuqizohen.

Neni 4

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 13

Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit ushtron veprimtarinë e tij deri në përfundimin e procesit të vlerësimit për kategorinë përkatëse të punonjësve, sipas nenit 6, të këtij ligji, brenda 1 viti nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.".

Neni 5

Nenet 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23, shfuqizohen.

Neni 6

Në nenin 24, pika 1, ndryshohet si më poshtë:

"1. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit drejtohet nga kryetari ose, në mungesë të tij, nga anëtari më i vjetër në moshë, i caktuar prej tij.".

Neni 7

Në nenin 29, pika 4, shfuqizohet.

Neni 8

1. Në të gjithë përmbajtjen e ligjit, fjalët "komisionet e vlerësimit" zëvendësohen me fjalët "Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit" dhe fjalët "sekretariateve teknike" zëvendësohen me fjalët "sekretariatit teknik pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit".

2. Në të gjithë ligjin, në nenet nga 31 deri në 62, pas fjalëve "trupa e vlerësimit" shtohen fjalët "ose Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat".

Neni 9

Neni 68, shfuqizohet.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 28.3.2019.